




Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo



Kuvendi i Kryeqytetit
Skupština Glavnog Grada –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

I mbledhjes së tetë i Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 31.10.2023,
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Pëllumb Bajçinovci, kryesues i KPF-së, anëtarët e KPF-së: Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri, Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi dhe Mirsad Vitia, Bahri Gashi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Osman Bllaca, Valbona Makolli - drejtor e Drejtorisë së Financave, Donika Çetta - drejtor e Drejtorisë së Parqeve, Mimoza Sylejmani - drejtor e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Shkëmb Manaj - Këshilltar ligjor.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Pëllumb Bajçinovci - kryesues i komitetit, duke propozuar këtë:

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së shtatë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2023 (TM3);
3. Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm “Lakërishta”, për bllokun “A-3, A-4, A-5, A-6, A-7, A-8” në Prishtinë;
4. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për botimin e librit “Shqipëria një histori në harta”;
5. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Kolegin e Kirurëgve të Kosovës;
6. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për organizimin e Garës Kombëtare të Robotikës, për vitin shkollor 2023/2024;
7. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për projektin “Children’s new Library at Pallati i Rinisë & Reading Hour for Prishtina’s Schools”;
8. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për projektin “Gjithçka rrëth IV”;
9. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për fushatën humanitare “Vrapo Babadimër”;
10. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare OJQ-së “Defy Them Community”;

Faqe1nga12

11. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për organizimin e konferencës “Growzillas L.L.C”;
12. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare NPL-së “Pallati i Rinisë”, SH.A.;
13. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare NPL-së “Sport Marketing”;
14. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e instalacionit “Ec me mua”;
15. Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet;
16. Të ndryshme.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, **Alban Zogaj** tha: me propozim të Kryetarit kërkojmë ta fusim në rend të ditës edhe një pikë: **Propozim-vendimi për transferimin e 14.5% të një ndarjeje buxhetore, të buxhetit të Komunës së Prishtinës, në një ndarje tjetër buxhetore gjatë vitit fiskal 2023.** Ndarjet kanë të bëjnë me dy subvencionime, të cilat i planifikojmë për dy ndërmarrje publike të Komunës së Prishtinës. Shuma e mjeteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi në vlerë prej 5 milionë e 850 mijë euro, i ndahet Ndërmarrjes publike lokale “Termokos” në vlerën prej 5 milionë e 350 mijë euro dhe Ndërmarrjes regionale të mbeturinave “Pastrimi” në vlerë prej 500 mijë euro. Po ashtu ai i arsyetoi këto ndarje në detaje. Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, neni 30, pika 30.2 i jep të drejtë një organizate buxhetore që me një arsyetim të vlefshëm nga udhëheqësi i organizatës buxhetore, mund ta autorizoj ministri transferimin e një pjese të një ndarjeje të organizatës buxhetore, në një ndarje tjetër të organizatës së njëjtë dhe ne në këtë drejtim kemi propozuar, kemi pasur diskutim edhe me Ministrinë e Financave, drejtorin e buxhetit që të transferojmë nga pjesa e Investimeve Kapitale në ndarjen buxhetore Transfere dhe Subvencione në vlerën prej 5 milionë e 850 mijë euro që janë të lira dhe nuk ndikojnë negativisht në ndarjen buxhetore e cila ndikohet, pra në pjesën e investimeve kapitale.

Këtë transfer prej një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër buxhetore e bazojmë edhe në kërkesën e ndërmarrjes “Termokos” për disa projekte konkrete të ndërmarrjes për zgjerimin e rrjetit në disa lagje, te Banesat e Bardha, te pjesa e Lakërishtes dhe te zona e Kalabrisë. Kërkesa e ndërmarrjes “Termokos” ka qenë më e madhe, ka qenë diku 9.4 milionë euro, por ne në këtë fazë po e ndihmojmë me 5.3 milionë euro, kurse në fazat tjera pastaj shohim se si vazhdojmë me këtë planifikim. Ndërsa sa i përket ndërmarrjes “Pastrimi” po ashtu edhe një kërkesë, për të mos thënë gati edhe urdhëresë, nga deponia e mbeturinave për të paguar borxhin që ndërmarrja ka ndaj deponisë. Borxhi është diku në vlerë totale afërsisht 1 milion euro, por ne aktualisht kemi vendosur që ta ndihmojmë ndërmarrjen me gjysmën e vlerës së borxhit, kurse pjesa tjetër e borxhit do të paguhet me këste sipas një programimi të pagesës së borxheve që e ka bërë ndërmarrja “Pastrimi”.

Gëzim Sveçla:- tha po dëshiron me i ndarë 5 milionë e gjysmë mjete në muajin nëntor, para një muaji e keni votuar buxhetin, pse nuk e keni bërë këtë ndarje buxhetore për vitin e ardhshëm. Këto mjete nuk mund të shfrytëzohen në këtë kohë, nuk ka punë që bëhet tani edhe po t'i ketë në llogarinë e vet “Termokosi” është kot.

Alban Zogaj: - tha ne po i thirremi ligjit. Ligji thotë se në 3-mujorin e fundit mund të bëhet një ndarje e tillë. Kjo duhet të kalojë, është e bazuar në ligj, e kundërtë nuk mund të ndodhë.

Gëzim Sveçla: - tha se as ligji nuk thotë që të kalojë, ka mundësi me një arsyeshmëri të fortë, cila është arsyeshmëria.

Alban Zogaj: - tha lëre këtë pjesë le të vendosë ministri për këtë punë, Ligji e thotë shumë qartë. Në këtë komitet lejohet të futen pika të reja, meqenëse lejohet e hedhim në votim edhe futjen e pikave dhe ecim tutje.

Gëzim Sveçla: - tha në mbledhje të Kuvendit kemi thënë që nuk i ndajmë më para “Pastrimit”, dy herë u kemi ndarë, vetë Kryetari ka thënë që është hera e fundit, e ju sot po dëshironi me u ndarë 500 mijë euro. A mendoni që do të shpenzohen 5 milionë e gjysmë në “Termokos” për dy muaj nëse sot ndahan.

Alban Zogaj: - tha edhe në pranverë shfrytëzohen. Po ashtu tha se deri në 5% mundemi pa miratimin e ministrit, Kuvendi Komunal e voton. Pastaj tha ne ishim në kontakt me drejtorin e buxhetit dhe Ministrinë e Financave dhe vendosëm të shkojmë me 15 %, me pikën 30.2, e cila thotë: Ministri me një arsyetim të vlefshëm nga udhëheqësi i organizatës buxhetore, në këtë rast Kryetari Përparim Rama, mund ta autorizoj transferimin e mjeteve.

Bahri Gashi: - pyeti se a ka komision në Komunën e Prishtinës që e ka vlerësuar që komuna bën t'i ndajë 5 milionë euro nga buxheti i komunës. Pastaj pyeti se me çfarë procedura po ia jep, me çfarë procedura ai do t'i përdorë, prokurimi i “Termokosit” nuk ka kapacitet me i menaxhuar 5 milionë euro të projekteve sepse nuk kanë njerëz, nuk kanë njerëz as me e mirëmbajt, as me e punuar këtë projekt. Anën tjetër, pavarësisht që është thënë që “Pastrimit” nuk do t'i japim para, më emergjent është “Pastrimi” por për çfarë po i jepni 500 mijë euro, për deponi, do me thënë nuk po zgjidhni problem. Po ashtu kërkoi sqarime se kur është vendosur nga një komision profesional që komuna mund t'i japë 5 milionë euro, kush janë këta ekspertë që e kanë vendosur këtë punë.

Alban Zogaj: - tha se kanë pranuar një kërkësë të argumentuar shumë mirë valide prej ndërmarrjes “Termokos” e cila është ndërmarrje e jona, nuk jemi duke ia dhënë askujt jashtë Prishtinës, por po ia japim një ndërmarrje e cila është 100% ndërmarrje e Komunës së Prishtinës dhe vetëm po e shtrijmë më tutje një organizatë e cila punon për qytetarët e Prishtinës. Sa i përket çështjes së mbeturinave jemi duke e zgjidh problemin, janë duke u blerë kamionët, ndërsa kontejnerët e ri do ta përmirësojnë situatën, por ne paralelisht duhet me punuar edhe me projekte tjera dhe ka fonde të lira. Ne mund ta ftojmë shefin e NP “Termokos” nëse kërkoni vjen e raporton në detaje për projekte, projektet janë të planifikuara prej ekspertëve të “Termokosit”.

Valbona Makolli: - tha se komisioni për paranë publike për Ligjin e Menaxhimit të Financave është vetëm kryetari, secili kryetar që vjen me votën e popullit ai ka të drejtë me shpenzuar në bazë të analizës së vet, të nënkyetarëve, të drejtorëve, këta janë komision për kryetarin kurse përgjegjësinë për paranë publike e merr kryetari i secilës komunë.

Jeta Rafuna: - e falënderoi nënkyetarin për prezantimin e pikës dhe si Grup i LDK –së do ta përkrahin.

Nora Kelmendi: - tha se nuk jemi kundër shtrirjes së rrjetit nëse keni shkuar në bazë të legjislacionit në fuqi në rregull jeni. Pse nuk raportojnë ndërmarrjet publike lokale në asamble se po i realizon projektet “Termokosi” a ka nevojë për mjete, duhet të raportojnë, asnjëherë nuk kanë reportuar, sepse në bazë të ligjit ato duhet të raportojnë, është edhe e gjetur e auditorit.

Alban Zogaj: - tha vjen kryeshei i ndërmarrjes “Termokos” në kuwend dhe raporton në detaje.

Bahri Gashi: - tha se ligji e parashev raportin finanziar të NPL – ve, ne nuk kemi pasur kurrë përveç kolegut Leutrim që e ka sjell prej NPB që ka qenë i mirë në krahasim me raportet tjera. Ne sot më 31 tetor

nuk kemi njohuri për gjendjen financiare të asnjë ndërmarrjeje se sa ka pas mjete në 2022 dhe më 31 dhjetor 2023 sa kanë me pas, meqë kjo është obligative të dimë se nëse i japim dikujt mjete të dimë që ka nevojë. **Mimoza Sylejmani:-** informoi se shefat e “Pallatit të Rinisë” e kanë premtuar se në takimin e radhës kanë me ardhur me raportuar si “Pallat i Rinisë” dhe për gjendjen financiare të detajuar.

Osman Bllaca: - tha, sa për informatë tani e tutje për çdo subvencion që shkon përmes Kuvendit kemi me lidh kontratë me përfituesin që ai me na i raportuar të gjitha aktivitetet, raportin financier, raportin e shpenzimit dhe krejt financat ku i ka parashikuar prej mjeteve që na ia kemi dhënë si subvencion.

Donjeta Sahatçiu: - kërkoi që të prezantojë pikën e 14 dhe 15 të rendit të ditës pasi që më vonë do të jetë në një takim tjeter.

Sa i përket pikës së 14-**Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e instalacionit “Ec me mua”**, tha se ka qenë pjesë e inicimit të projektit andaj po e prezentoj këtë pike. Kemi marrë një kërkesë nga SOS – Fshati ku fëmijët të cilët nuk kanë kujdesje prindërore, së bashku me një artiste kanë bërë njëfar vepre ku kanë vendosur shputat e tyre në një masë të argjilës dhe kanë kërkuar me marrë një hapësirë, një mural brenda qytetit për këta fëmijë. Kur e kam pranuar kërkesën përmes Drejtorisë së Kulturës, jam takuar dhe ju kam sugjeruar se ato shputa në aso forme në mural nuk janë të duhura dhe kam propozuar idenë që të bëjnë një instalacion. Është një vepër artistike dhe së bashku me drejtoren e parqeve kemi shkuar dhe e kemi propozuar Parkun e Qytetit dhe ideja ka qenë me vendos një hapsirë ku ka qarkullim dhe ku fëmijët e tjerë informohen dhe vetëdijësohen për këta fëmijë, të cilët nuk kanë përkujdesje prindërore dhe e kemi mbështet si iniciativë.

Sa i përket pikës së 15- **Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet**, siç e dini në një mbledhje të kuvendit e kemi marrë një vendim, e kemi caktuar një komision ku bëjë pjesë edhe unë dhe në atë vendim e kemi pasur një zyrtar të vetëm, i vetmi që ka qenë për adresë, ai është Veton Krasniqi, i cili ka qenë i punësuar në Kryeqytet me kontrat mbi vepër dhe me kërkesën e fundit që t'i lirojnë këto vende pune ju është dashur të mbyll kontratën kështu që ne ju kemi drejtuar Zyrës ligjore dhe Drejtorisë së Urbanizmit ta zëvendësojnë këtë zyrtar, zëvendësimi është bërë, kështu që e kemi obligim në Kuvend ta votojmë dhe komisioni të vazhdojë punimet në përbërjen që e ka.

Donika Çeta: - e dha arsyetimin lidhur me Propozim- vendimin për caktimin e lokacionit për vendosjen e instalacionit “EC me mua”, i cili do të vendoset në Parkun e Qytetit e kemi edhe projektin dhe mendoj ky vend është më i duhuri për këtë projekt.

Jeta Rafuna: - propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës **Propozim-vendimi për subvencionimin e OJQ “Bright Minds” për projektin ”Shkolla 3-Dimensionale e Prishtinës”** ku qëllimi i kësaj kërkese është për suvencionimin e projektit “Shkolla 3-Dimensionale e Prishtinës”, pra bëhet fjalë për printerat 3D, këta e kanë dërguar kërkesën dhe projektin. Vlera e subvencionimit që ka kërkuar kjo OJQ është 90 mijë euro, kërkoi nga Drejtoria e Financave të na tregojë se a mundemi me shty përparrë këtë subvencionim.

Valbona Makolli: - tha se vlera që është e kërkuar nuk ka mundësi, më e vogël po.

Nora Kelmendi: - pyeti pse këta nuk kanë aplikuar kur ka qenë shpallja publike për ndarjen e subvencioneve në Drejtorinë e Arsimit.

Kryesuesi: u përgjigj se këto janë subvencione direkt të kryetarit të cilat nuk mund të kalojnë pa votën tonë.

Gëzim Sveçla:- kërkoi sqarime nga Osmani se a janë këto subvencione në rregull ligjërisht, a ka të gjetura të auditorit për këto subvencione, apo i përsërisim shkeljet e vitit të kaluar dhe a respektohen në parim.

Osman Bllaca:- dha sqarime lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësi.

Valbona Makolli:- tha nuk ka ndonjë nen apo Rregullore ku përcaktohen mjetet e kryetarit se në çfarë mënyre ndahan.

Osman Bllaca: - dha sqarime se janë në hartim të ndryshim - plotësim të rregullores së brendshme që kemi paraparë gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit, të përcaktohet se në çfarë forme, ku ka të drejtë të ndajë subvencione, çfarë shume ka të drejtë të ndajë dhe me qenë gjitha kriteret dhe kushtet sikurse siç janë për thirrje publike dhe këto do të caktohen këtu përmes Kuvendit.

Donjeta Sahatçiu: - tha është mirë kur kemi pika që ndërlidhen me drejtoritet përkatëse me pas një konsultim paraprak për projektet që do me i subvencionuar kryetari dhe kësijoj të vijë dikush nga drejtoritet dhe t'i mbështes pikat të cilat po duan t'i subvencionojnë.

Bahri Gashi: - tha se Drejtoria e Arsimit është dashur me u marr më herët me këtë problematikë shumë para se me ardhur si subvencion se drejtoria është në rrjedha, i ka nevojat e veta dhe mjetet me u nda përmes Drejtorisë së Arsimit.

Gëzim Sveçla: - pyeti se pikat shtesë që erdhën a duhet votuar për të hyrë në rend dite, pasi kështu gjithmonë kemi vepruar dhe është procedurë.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e Alban Zogaj që të futet në rend të ditës pika - **Propozim-vendimi për transferimin e 14.5% të një ndarjeje buxhetore të buxhetit të Komunës së Prishtinës në një ndarje tjetër buxhetore gjatë vitit fiskal 2023.**

Kryesuesi konstataoi se me **5 vota për** dhe **4 kundër**, **asnjë abstenim** u miratua propozimi i **Alban Zogaj** që të futet në rend të ditës pika e sipërcekur.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e **Jeta Rafunës** që të futet në rend të ditës pika - **Propozim-vendimi për subvencionimin e OJQ "Bright Minds" për projektin "Shkolla 3-Dimensionale e Prishtinës".**

Kryesuesi konstataoi se më **5 vota për** dhe **4 kundër**, u miratua propozimi i **Jeta Rafunës** që të futet në rend të ditës pika e sipërpërmenur.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e **Donjeta Sahatçiu**, **Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e instalacionit "Ec me mua".**

Kryesuesi konstataoi se me **5 vota për**, **0 kundër**, **0 abstenim** u miratua propozimi i **Donjeta Sahatçiu** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e **Donjeta Sahatçiu**, **Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkessave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet.**

Kryesuesi konstatoi se me 5 vota për, 0 kundër, 0 abstenim u miratua propozimi i Donjeta Sahatçiu dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës me ndryshimet e bëra me futjen e dy pikave të reja në rend dite:

17. Propozim-vendimi për transferimin e 14.5% të një ndarjeje buxhetore të buxhetit të Komunës së Prishtinës për një ndarje tjetër të buxhetit gjatë vitit fiskal 2023.

18 .Propozim-vendimi për subvencionimin e OJQ “ Bright Minds” për projektin ”Shkolla 3-Dimensionale e Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se me 5 vota për, 0 kundër, 0 abstenim u miratua rendi i ditës me dy pikat shtesë.

Gëzim Sveçla: - tha a ka mundësi një interpretim ligjor, po kalojnë pikat me 5 vota, ndërkaq Komiteti për Politikë e Financa i ka 11 anëtarë, duke shtuar se a është ligjërisht në rregull.

Osman Bllaca: - tha kjo është në rregull ligjërisht.

Gëzim Sveçla: - tha a ka mundësi me na gjete bazën ligjore që po mendoni që është kështu.

Kryesuesi: - tha për sqarim është dashur me qenë prezent zyrtari i Zyrës ligjore, mendoj tash e tutje ka me qenë obligative me qenë një zyrtar i zyrës ligjore për sqarime në takim.

Nora Kelmendi: - tha tash e tutje se cilën pikë veç e veç ka me prezantuar drejtori i cili është përgjegjës për pikën.

Gëzim Sveçla: - tha ai drejtor që nuk është prezent me prezantuar pikën nuk do të kalojë ajo pikë.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2023 (TM3)

Lidhur me **Raportin finansiar buxhetor të Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2023 (TM3)** në pika të shkurta informoi **Valbona Makolli**, drejtore.

Mirsad Vitia: - tha se në faqen 22 është një tabelë – Pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve për vitin 2023 dhe krasimi me vitet paraprake, kërkoi sqarime lidhur me këtë tabelë.

Valbona Makolli: - dha sqarime lidhur me çështjen e tabelës të paraqitur nga parafolësi.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti finansiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2023 (TM3) dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

Pika e tretë

Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm “Lakërishta”, për bllokun “A-3, A-4, A-5, A-6, A-7, A-8” në Prishtinë

Lidhur me këtë pikë, shkurtimisht informoi **Mimoza Sylejmani** - drejtore, duke cekur se me kërkesën e kryetarit dhe disa akterëve, të cilët bëjnë pjesë në këtë lokacion kemi marrë një sugjerim që të sjellim këtë pikë. Arsyja është se ky plan është votuar në vitin 2007 dhe nuk korrespondon me infrastrukturën rrugore e cila është marrë edhe si vendim në vitin 2012, sipërfaqja në tërësi është 7.4 ha, në këtë seancë e kemi vetëm iniciim që të formohet një grup punues prej shumë drejtorive dhe të punojnë Planin Rregullues të Hollësishëm për këto bloqe.

Gëzim Sveçla:- pyeti se kush janë disa akterë të tjera.

Mimoza Sylejmani:- dha sqarime lidhur me pyetjen e parashtruar nga parafolësi.

Gëzim Sveçla: - pyeti se a kanë pasur kërkesë me shkrim nga këto institucione, nëse po a mund të na i dërgoni.

Mimoza Sylejmani: - tha se nuk ka pasur kërkesë me shkrim nga institucionet, ndoshta kryetarit i ka dhe nëse i ka kryetari kërkesat ua dërgojmë.

Gëzim Sveçla: - pyeti çka është si ide që duhet m'u reviduar.

Mimoza Sylejmani: - u përgjigj në pyetjen e parashtruar të parafolësit.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm “Lakërishta”, për bllokun “A-3, A-4, A-5, A-6, A-7, A-8” në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për botimin e librit “Shqipëria një histori në harta”

Valbona Makolli: - tha qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare për Bejtullah Destanin për botimin e librit “Shqipëria një histori në harta” ku shuma e mjeteve të ndara është 16.500,00€.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për botimin e librit “Shqipëria një histori në harta” dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Kolegjin e Kirurëgve të Kosovës

Valbona Makolli: - tha qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare për Kolegjin e Kirurëgve të Kosovës , për organizimin dhe mbajtjen e Kongresit të tretë klinik të KKK-së, shuma e mjeteve të ndara është 4, 500.00 €, kurse shuma është siguruar nga kategoria e subvencioneve.

Nora Kelmendi:- pyeti pse për mbajtjen e Kongresit kur është kryer Kongresi, pse ju jepni 4,500.00€.

Valbona Makolli:- u përgjigj në pyetjen e parashtruar.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Kolegjin e Kirurëgve të Kosovës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për organizimin e Garës Kombëtare të Robotikës, për vitin shkollor 2023/2024

Valbona Makolli: - tha qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare për Fondacionin “Unë e dua Kosovën”, për organizimin e Garës Kombëtare të Robotikës për vitin shkollor 2023/2024, shuma e ndarë është 20.000,00 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

Gëzim Sveçla: - pyeti se a është kërkesë e kryetarit apo shefit të kabinetit.

Valbona Makolli: - tha këto janë kërkesa vetëm të kryetarit.

Nora Kelmendi: - pyeti, cila OJQ është kjo.

Valbona Makolli: - tha është Fondacioni “Unë e dua Kosovën”.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për organizimin e Garës Kombëtare të Robotikës, për vitin shkollor 2023/2024 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për projektin “Children’s new Library at Pallati i Rinisë & Reading Hour for Prishtina’s Schools”

Valbona Makolli: - tha është projekt që e ka përkrahur kryetari, shuma e mjeteve të ndara është 80.000,00 €, është një projekt 3-vjeçar që e ka paraqitur kjo OJQ.

Nora Kelmendi: - tha e kam shikuar një emision që është e Kristales kjo OJQ, e gruas së kryetarit, vetë e ka treguar në një emision, a nuk është ky konflikt interesit.

Kryesuesi: - tha nuk e di këtu po figuron dikush tjeter ndoshta ka qenë bashkëiniciativë, ka mund me qenë një iniciativë e dikujt tjeter që e përkrah dikën tjeter për qëllime më madhore, andaj e diskutojmë edhe në asamble, por në këtë projekt po figuron dikush tjeter.

Donjeta Sahatçiu: - tha mendoj se duhet të koordinohemi që secila kërkesë për subvencione të ketë të paktën një përfaqësues të drejtorisë që tregon për projektin në fjalë dhe e ndihmon personin që e merr përgjegjësinë ta mbrojë atë pikë.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për projektin “Children’s new Library at Pallati i Rinisë & Reading Hour for Prishtina’s Schools” dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për projektin “Gjithçka rrëth IV”

Valbona Makolli: - tha qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare për projektin “Gjithçka rrëth IV”, një bashkëprodhim teatrор ndërmjet Tiranës dhe Prishtinës, shuma e mjeteve të ndara është 14.000,00 €.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për projektin “Gjithçka rreth IV” dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e nëntë

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për fushatën humanitare “Vrapo Babadimër”

Valbona Makolli: - tha qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare për fushatën humanitare “Vrapo Babadimër”, fushatë humanitare tradicionale, e cila mbahet në Prishtinë, shuma e mjeteve të ndara është 4.500,00 €, shumë kjo e ndarë nga kategoria e subvacioneve.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për fushatën humanitare “Vrapo Babadimër” dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dhjetë

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare OJQ-së “Defy Them Community”

Valbona Makolli: - tha qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare OJQ-së “Defy Them Community” për mbështetje të Rock School Prishtina në edukimin e gjeneratave të reja, fuqizimin e artistëve të rinj, organizimin e aktivitetave kulturore dhe performimin e artistëve të rinj, shuma e mjeteve të ndara është 5.000,00 €, shumë kjo e ndarë nga kategoria e subvacioneve.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare OJQ-së “Defy Them Community” dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për organizimin e konferencës “Growzillas L.L.C”

Valbona Makolli: - tha qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare për organizimin e konferencës “Growth Tank”, konferencë që ka për qëllim sjelljen e ekspertëve më të mëdhenj të fushës së marketingut digital në Prishtinë, shuma e mjeteve të ndara është 5.000,00 €.

Gëzim Sveçla:- pyeti a po e subvencionojmë SHPK-në (Shoqerinë me përgjegjësi të përkufizuar).

Valbona Makolli:- tha nuk është e përcaktuar në irregullore se mundemi vetëm OJQ - të apo individët, por e pyes unë Zyrën ligjore, por nuk ka asnjë përkufizim.

Gëzim Sveçla:- pyeti a e dini që ky subjekt që po e subvenciononi çfarë statusi juridik ka.

Bahri Gashi:- tha se kjo “Growzillas” është biznes, drejtoreshë nuk është ideja a e lejon ligji a jo një kompani private, duke shtuar se gabim është se nuk mundesh me financuar biznesin dhe gabim është nëse i ndahan 5.000,00€.

Osman Bllaca:- tha në mbledhje vjen kryetari dhe e arsyeton këtë pikë.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për organizimin e konferencës “Growzillas L.L.C” dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e dymbëdhjetë

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare NPL-së “Pallati i Rinisë”, SH.A

Valbona Makolli: - tha qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare NPL-së “Pallati i Rinisë”, SH.A, për të forcuar kapacitetet dhe operacionet e ndërmarrjes, shuma e mjeteve të ndara është 125.000,00 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

Bahri Gashi:- tha jam me ju ndihmuar NP-ve, por të sjellin raportin përcjellës sa më parë, gjendjen financiare sa mjete kanë në xhirolllogari, sa kanë borxhe, sa ju kanë borxhe.

Valbona Makolli: - tha se i ka kërkuar raportet prej aksionarëve të kryetarit, jo të kuvendit se nuk kam të drejtë, ata shumica e NPL-ve i kanë sjell raportet, por e drejtë e Kuvendit është prej aksionarëve që i kemi votuar me kërkuar këto raporte, por shumicën e tyre kryetari i ka.

Bahri Gashi:- tha aksionarët asnjëherë nuk kanë raportuar në Kuven, kanë ardhur kryeshefat kanë raportuar, por NPL –të duhet të paktën të dërgojnë raport me shkrim siç e kérkon ligji, jo aksionarët e kryetarit, por aksionarët se asambleja është pronare e ndërmarrjeve e jo kryetari.

Milazim Vitija: - sa i përket raporeve të NP-ve vitin e kaluar ka qenë viti i parë dhe jemi dakorduar që të jenë si informata megjithëse disa kanë qenë raporte, sepse me raportuar në vitin e parë duhet me raportuar ata aksionarë që kanë qenë paraprak jo ne sepse mbyllja e vitit fiskal bëhet në mars.

Bahri Gashi:- tha ti si aksionar nuk mund të bësh raportin se nuk jeni të thirrur të bëni atë raport, raportin financiar e bënë ndërmarrja me kërkesa specifike të aksionarëve dhe vjen në asamble.

Milazim Vitija: - tha kanë ardhur ato raporte në muajin maj, i keni larguar sepse keni thënë nuk janë raporte veç informata, por më vonë ka ndodh çka ka ndodh në asamble, ndryshimi i kryesuesit dhe ju s'keni qenë 4 muaj në seanca. Kjo është arsyaja pse nuk kemi raportuar deri më tani, kurse tani është koha të raportojë secili për ndërmarrjet e veta. Për vitin e kaluar raporti i “Termokosit” ka qenë shumë i mirë dhe gjithçka ka përfshirë, ka qenë raporti NPB-së shumë i mirë, mirëpo te disa ndërmarrje, disa kanë pasur ndryshime të aksionarëve s’kanë qenë të plotë kjo ka qenë arsyaja pse kanë qenë disa informata.

Bahri Gashi: - tha raporti i “Hortikulturës” ka qenë raport 3- mujor, raporti i NPB ka qenë më i kompletuar, raporti i “Termokosit” ka qenë 50% dhe ” Parkingu” i ka sjell pasqyrat financiare.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare NPL-së “Pallati i Rinisë”, SH.A dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e trembëdhjetë

Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare NPL-së “Sport Marketing”, SH.A

Valbona Makolli: - tha qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare NPL-së “Sport Marketing”, SH.A për shkak të problemeve financiare me të cilat po përballet kjo ndërmarrje, kurse shuma e mjeteve të ndara është 50.000,00 € për pagat e punëtorëve, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

Bahri Gashi: - tha se duhet subvencionuar për paga, pasi punëtorët nuk i kanë marrë pagat.

Valbona Makolli: - dha sqarime shtesë.

Bahri Gashi: - tha se cilado NPL që kérkon para, kryetari pasi që po vendos aq lehtë t’ju japë para duhet me menduar se çka po bëhet me këto NP, është viti i dytë dhe nuk po mendoni çka me bëni me këto ndërmarrje.

Osman Bllaca: - dha sqarime.

Kryesuesi: - tha besoj se janë disa projekte që kanë me ju dhënë më së largu deri në fillim të vitit të ardhshëm dhe duhet me filluar me u rigjeneruar, përndryshe për neve tjerëve që jemi pjesë e saj edhe për ju zotëri Gashi ju kuptoj plotësisht se kur të subvencionosh diçka e sheh se nuk po lëviz nuk ndihesh mirë.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare NPL-së “Sport Marketing”, SH.A dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërmëbhjetë

Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e instalacionit “Ec me mua”
dhe

Pika e pesëmbëdhjetë

Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet.

Kryesuesi: - tha për këto dy pikat 14 dhe 15 ka dhënë sqarime nënkyetarja Donjeta Sahatçiu.

Kryesuesi: - konstatoi se u përkrahen Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e instalacionit “Ec me mua” dhe Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet dhe dërgohen në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtëmbëdhjetë

Propozim-vendimi për transferimin e 14.5% të një ndarjeje buxhetore të buxhetit të Komunës së Prishtinës në një ndarje tjetër buxhetore gjatë vitit fiskal 2023

Kryesuesi: - tha sa i përket Propozim-vendimit për transferimin e 14.5% të një ndarjeje buxhetore të buxhetit të Komunës së Prishtinës në një ndarje tjetër buxhetore gjatë vitit fiskal 2023, për këtë pikë dha sqarime nënkyetari Alban Zogaj.

Leutrim Retkoceri:- dha sqarime se te kjo shuma 500.00,00 € për kompaninë “Pastrimi” është për borxhin që ka të bëjë me deponinë, para dy viteve që është një marrëveshje me këtë deponi. Ata i kanë dërguar disa letra menaxhmentit të ri që në rast se nuk bëhet pagesa do të aplikohet kamata prej 8 % dhe mylllet deponia.

Bahri Gashi:- pyeti sa është borxhi.

Leutrim Retkoceri: - dha sqarime për pyetjen e parashtruar.

Valbona Makolli: - tha problemi është se ajo është regionale nuk është kompani lokale, duhet me diskutuar edhe me Lipjanin, Drenasin, Obiliqin, Fushë Kosovën, kurse për pjesën tonë që e kemi ne në përqindje i kemi nda 100.000,00 €.

Bahri Gashi: - tha problemi është te ne komuna, gjeni një mes dhe myllni borxhin e kompanisë krejt ligjërisht dhe merreni kompaninë vetë, në mënyrë që të ndaheni prej regjionit.

Leutrim Retkoceri:- pyeti a ka ligjërisht pengesa me myll krejt borxhin.

Valbona Makolli: - dha përgjigje në pyetjen e parashtruar nga parafolësi.

Osman Bllaca:- tha Komuna e Prishtinës ka qenë gjithmonë tatimpagusja më e rregullt e mbeturinave, ndërsa komunat tjera nuk paguajnë.

Bahri Gashi: - pyeti se a ka paguar ndonjë kompani regionale këtë borxhin që ne po ua paguajmë deponisë.

Leutrim Retkoceri: - dha sqarime se kur i ka paguar Komuna e Prishtinës 100.000,00 € herën e kaluar, Lipjani ka paguar 17.000,00€ Podujeva 24.000,00 €, Fushë Kosova dhe komunat tjera nuk kanë paguar asgjë. Po ashtu tha në mes të kësaj situate 500.000,00€ problemi i "Pastrimit" nuk është vetëm te deponia, por është edhe te gjendja e rendë financiare e kësaj ndërmarrjeje se përveç mbylljes së borxhit ka të bëjë me një borxh të kaluar kështu që duheni me plotësuar Vendimin për ndarjen edhe 350.000,00 € për bashkëfinancimin për blerjen e kamionëve të ri që e bënë ndërmarrja përvëç këtyre që i ka kontraktuar komuna. Pra ndryshoni këtë pjesë, plotësoni këtë vendim në këtë pjesë dhe në seancë ecim tutje.

Valbona Makolli: - tha kërkesën do t'ia përcjelli kryetarit.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për transferimin e 14.5% të një ndarjeje buxhetore të buxhetit të Komunës së Prishtinës në një ndarje tjetër buxhetore gjatë vitit fiskal 2023 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatëmbëdhjetë

Propozim-vendimi për subvencionimin e OJQ "Bright Minds" për projektin "Shkolla 3-Dimensionale e Prishtinës"

Kryesuesi: - tha, lidhur me këtë pikë ka dhënë sqarime Jeta Rafuna kur e propozoi që të futet në rend dite.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për subvencionimin e OJQ " Bright Minds" për projektin "Shkolla 3-Dimensionale e Prishtinës" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

Procesmbajtësja:

Shyrete Islami

Kryesues i Komitetit

Pëllumb Bajçinovci

